

ZERI I POPULLIT

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TE PPSH

Viti I 43-të i botimit
Nr. 92 (11.462)

E mërkurë, 17 prill 1985

Çmimi 30 qindarka

**VEPRA E SHOKUT ENVER HOXHA ESHTË
DERDHUR NE TE GJITHA THEMELET E
SHENDOSHA MBI TE CILAT ESHTË
NGRITUR SHQIPERIA E SOTME.**

POPULLI DHE PARTIA NDEROJNE ME MIRENJONJE TE THELLE VEPREN E PAVDEKSHME TE SHOKUT ENVER HOXHA

IDEALI I PARTISE DHE I SHOKUT ENVER HOXHA DO TE JETOJE GJITHMONE

Mbarë populli ynë po jeton peshën e dhimbjes së rëndë për humbjen e Udhëheqësit të madh të Partisë së Popullit, shokut Enver Hoxha. Populli e Partia e përcollën birin e tyre të lavdishëm me lotë në sy e pikëllim në zemër. Kurrë ndonjëherë njerëzit tanë nuk kanë provuar dhimbje si kjo, kurrë ndonjëherë Shqipëria nuk derdhi kaq lotë. Kjo dhimbje e thellë është shprehje e dashurisë së pakufishme që ka populli për Partinë, për themeluesin e Udhëheqësin e saj, shokun Enver. Mijëra e mijëra letra nga punëtorë, kooperativistë, nga gra dhe të rinj, nga ushtarë dhe studentë, nga veteranë dhe nxënës të shkollave, kanë vajtur këto ditë në komitetet e Partisë të rretheve dhe në Komitetin Qendror të Partisë. Mijëra e mijëra poezi dhe këngë po afishohen kudo, lexohen nëpër mbledhje, kokë më kokë me njëri-tjetrin, ose u dërgohen gazetave e Radiotelevizionit. Në të gjitha këto ka një shpirt të jashtëzakonshëm dashurie që thellë që ndjehet në çdo fjalë e varg, në çdo premtim që njerëzit tanë i bëjnë Partisë.

Kjo dashuri për shokun Enver, e lartë si malet dhe e thellë sa deti, lindi e u rrit në lufta të gjata, në përpjekje heroike, në ditë të vështira dhe në gëzim. Një gjysëm shekulli Enver Hoxha mendoi e punoi për popullin, qau hallet me të, e dëgjoi si bir dhe u vu në krye si prijës. Me fjalën e Enver Hoxhës, me mendimin e tij të mënçur e të urtë, populli njohu vërtetë dhe Shqipëria socialiste u rrit e u forcua. «Për ne, ushtarët e Partisë shkruan shoku Enver në Përhëndetjen e tij me rastin e 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, nuk mund të ketë kënaqësi më të madhe se kjo, kur të shohim ty, o popull, zot të fateve të tua, të gëzuar, të lumtur, të lirë, në një Shqipëri sovranë dhe të pavarur, në një Shqipëri të kthyer në këshill të pamposhtur e me zhvillim të pandërprerë socialist». Me këtë dashuri për popullin jetoi e punoi Enver Hoxha, dhe ai e vuri në zemër për ta mbajtur në jetë të jetëve.

Shoku Enver Hoxha u nda nga Partia që ai krijoi e iu kushtua gjithë jetën, u nda nga populli që e dëshi aq shumë. Po ai la pas një Vepër të madhe, me vlerë të pallogaritshme për sot e për brezat që do të vijin. Fryt i kësaj Vepre tepër të gjërë janë fitoret e mëdha që kemi arritur, janë lartësitë ku është ngritur shoqëria jonë socialiste, janë rrugët e hapura, perspektivat e qarta drejt së ardhmes.

Enver Hoxha erdhi në skenën e historisë shqiptare kur koha kish nevojë më shumë se kurrë për të. Ai erdhi si organizator demonstratash e në ballë të tyre, si ilegal me bomba në brez, erdhi me qartësinë e ideve të mëdha të Marksit e të Leninit, nën flamurin e të cilëve bashkoi komunistët e devotshëm, ngriti në këmbë një Parti trime që e kaliti në betejë. Lufta që udhëhoqi Partia ishte me sakrificë, që i këputi shumë nga lulet e trimave. Ra Qemali, Vasili, Vojua, Mistua, Margarita... Ranë shumë. Dhe çdo humbje i rëndonte në shpirt Komisarit. Sa e sa herë, pas çdo lajmi të rëndë u shtrënguan ato grushte e lindte një trakt me thirrjen luftarake «Zemrat lart, shokë!» me nënshkrimin e dashur «Taras», «Shpati»...

Jeta e Enver Hoxhës ishte e gjitha luftë, për çli-

rimin e vendit dhe për ndërtimin e Shqipërisë së Re, për përparimin e bujqësisë e të industrisë, për modernizimin e tyre, për forcimin e mbrojtjes, për krijimin e fuqizimin e shkencës sonë, të artit e të kulturës socialiste. Ishte luftë me armiqtë, të jashtëm e të brendshëm, me komplotet e kurthet e tyre të përbindshme që popullit t'i hidhnin prangat e skllavërisë, ishte luftë që fushat të zverdhnin nga gruri, që ne të kishim Metalurgjik, Fierzë e Koman që të lulëzonin këngët e vallet tona të bukura... Në këta 40 vjet miq dhe armiqtë e njohën vitalitetin e Partisë sonë, guximin e parimesin e saj marksiste-leniniste, njohën guximin e Enver Hoxhës për t'u ngritur mbi çdo armik dhe fuqinë e mendimit të tij në mbrojtje të parimeve të marksizëm-leninizmit. Vetëm një udhëheqës si Enver Hoxha, mund të mësonte e ta kaliste Partinë duke e kaluar në dallë nga më të vështirat e të pashoqe në histori. Qëndresa që ajo u ka bërë bllokadave e komplotëve të pabesa të revizionistëve të shumë ngjyrave është e pashembullt dhe për këtë meritë e madhe i përket Udhëheqësit të lavdishëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Kjo luftë e ashpër është pjesë përbërëse e jetës dhe praktikës revolucionare të Partisë sonë, pjesë përbërëse e Vepres së madhe të shokut Enver.

Shoku Enver interesat e Partisë kudoherë i vuri mbi gjithçka. Me mendimin e largpamësinë e Udhëheqësit, me guximin e trimërinë e Strategut, me durimin e Mësuesit nuk u lodh t'u mësojë komunistëve, t'i kështillojë, të marrë mendime e të kontrollojë, për të rritur rolin e Partisë, të organizatës-bazë, për kalitjen ideologjike të Partisë. Enver Hoxha, që nga dita e 8 Nëntorit të parë e deri sa i pushoi së rrahuri zemra, në gati 45 vjet, luftoi për një Parti të fortë me unitet të çeliktë marksist-leninist, të pastër në përbërje, të ngritur ideologjikisht e politikisht, për një parti luftarake me komunistë militantë e revolucionarë. Populli ynë e ka jetuar dhe e jeton çdo cast forcen transformuese të ideve të Partisë, unitetin e radhëve të saj, shembullin e devotshmërisë, mishërimin e interesave të vetë popullit, për përparimin e tij, për rritjen e mirëqenies, forcimin e Atdheut. Të jenë luftëtarë për vijën e Partisë, të lidhur ngushtë me popullin, në vijë të parë të luftës; kështu i mësoi komunistët Enver Hoxha. Atdheun nuk do të na e çlirojnë të tjerët, socializmin nuk mund të na e ndërtojnë të tjerët, përveçse me gjakun tonë, me duart e djersën tonë; kështu e mësoi Partinë e popullin Enver Hoxha. «Asgjë nuk mund t'i largojë Partinë e popullin tonë nga këto mësim, tha shoku Ramiz Alia në mitingun e përmortshëm në kryeqytet, asnjë forcë nuk mund t'i largojë nga politika parimore, nga politika e Enver Hoxhës. Si në të kaluarën, ashtu edhe në të ardhmen Partia jonë, udhëheqja e saj, mbarë populli ynë, klasa punëtorë, fshatarësia kooperativiste, rinia, gratë, inteligjencia, veteranët e luftës dhe ushtarët do të ecin kudoherë përpara në atë rrugë që çeli Revolucionin Popullor dhe që e konfirmoi ndërtimi i socializmit, në rrugën e mbrojtjes së interesave të larta të Atdheut dhe të çështjes së revolucionit».

NE THEMELET E PUSHTETIT TE POPULLIT

(Nga Odriçani në Përmet)

Udhëtojmë sot nëpër muzg drejt Përmetit, qytetit historik që e dëshi kaq shumë shoku Enver Hoxha. Udhëtojmë me një pikëllim si një shkëmb të madh në zemër. Dhimbja t'a kyç gojën, është ndoshta udhëtimi më memec në jetën tonë. Mbrëmja vjen me një qiell të errët. Më mirë kështu.

Qyteti që e quajti bir

Në hyrje të Përmetit, në tablonë e madhe murale Komandanti vjen kaluar drejt Kongresit Historik. Dhe të kumbojnë në vesh fjalët e tij: «Gjithmonë e kujtoj me mall

Përmetin e majit 1944 me pamjen e tij festive, sallën e Kongresit të zbukuruar, mensën e pastër me tavolina të gjata, shokët që u kërcitën tytat, e armëve kur takoheshin me njëri-tjetrin». Jo, s'mund të ecësh i qetë dhe i shpenguar sot rrugëve të Përmetit. Përmeti i këtyre ditëve si e gjithë Shqipëria, nuk është i gëzuar. Lajmi i hidhur tronditi çdo vatrë të tij. «Dhimbja jonë, tha një punonjës i ndërtimit i karpërcen qindra herë dhimbjen e nënës dhe të babës». E madhe është dhimbja. Populli i Përmetit vajtoi me shpirt, me zemër, me lot, me zë. «Njoftimi që morëm është tërmet e

shkuar tërmete», thuhet në letrën e kooperativistëve të Kutalit drejtuar Komitetit të Partisë së Rrethit. «Unë jam shumë i moshuar, tha Peci Çulli, një plak nga Lupcka, por jetën do t'a zgjas vetëm për të vënë në jetë atë që na porosi Enveri. «Enver Hoxha nuk ka vdekur, se ka ditur t'i bëjë vend vetes në çdo zemër tonë» - tha i përbotur brigadieri Bashkim Hodaj nga Këlcyra. Njerëzve u rënkon dhimbja në shpirt. Qan Përmeti, Kafshon buzën dhe qan. Ai si gjithë atdheu, ka amanetin e tij të madh. Nga kjo sallë e thjeshtë shoku Enver i

(Vijon në faqen 2)

TIRANE

Sa pranë pikëllimin me forcën!

Çdhimbje të madhe po ndjen këto ditë Tirana! Tirana e Themelimit të Partisë, Tirana e barrikadave, Tirana e punëve të mëdha, Qyteti Hero. Çdhimbje po ndjen ajo! Ajo nxjerrka ca fjalë që kanë brenda edhe optimizmin, edhe forcën. Si ndodhka kështu?

«Babai im ka qenë një myzeqar shumë i varfër, që ka vuajtur shumë për kotheren e bukës, - thotë punëtori i policisë Aristidh Gjika. Unë kam lindur në vitet e socializmit dhe së bashku me qumështin e nënës, thitha edhe mësimet e shokut Enver. Ju do të mbeten i paharruar në zemrën dhe mendjen time, të një djali myzeqar, që shërben me nder dhe krenari në mes të Tiranës, i shtrenjti Enver». Një komunist në kombinatin e autotraktorëve «Enver Hoxha» mendohet, mendohet dhe qëndis fjalët: «Brezat e ardhshëm do

të na kenë zili ne që jetuam, luftuam e punuam në epokën e Enver Hoxhës». Një nënë tiranase, 85-vjeçare, duke puthur portretin e shokut Enver, tha: «Nga tërë këto vite, o biri i nënës, shumë pak mbajte për vete, të tjerat ua dhe halleve të popullit tënd».

Është ora e leksionit të historisë së Partisë në vitin e parë të degës mekanike në Universitet. Pedagogu Rajmond Pengu «e prishi» programin. Ai s'foli për temën e radhës, por për jetën dhe vepren e shokut Enver. Studentët dhe studentet kanë ulur kokën dhe nuk flasin. Ata qajnë. Qajnë dhe dëgja shkruajnë në fletoret dhe kapakët e fletoreve. Çfarë shkruajnë? Në fund të orës zbulohet se ato kanë shkruar:

- Enver, jemi me ty!
- Enver, njeriu më i dashur i rinisë.

- Enver nuk vdes kurrë.
- Enver është përherë midis nesh.
- Enver do të rrojë në shekuj...
Pionierja Gentiana Pepa, komandante e çetës në shkollën «De Rada», ka një kujtim të bukur nga takimi me shokun Enver. Ajo thotë se i duket sikur xhaxhin Enver e puth dhe e përgafon çdo ditë, sikur e porosit që t'i puthë dhe t'i përgafojë të gjithë pionierët e çetës. Çfarë ke kështu në dorë, ti Gentiana? Dhe ajo, me lotë në sy, lëshoi një ballon në ajër, ku është shkruar: «Xhaxhi Enver do të rrojë përherë!».

Sa e vështirë qenka t'i rrjeshtosh të gjitha këto fjalë të skaltura, këto fjalë të qëndisura! Dhe kush i skaltit ato, kush i qëndis ato? «Të zgjahu», është zemra. Ato i skaltit dhe i qëndis dashuria e madhe e njerëzve tanë për Enver Hoxhën.

ASTRIT NURI

DO TE RROJE NE SHEKUJ ENVERI YNE

- Nga letrat dhe telegramet dërguar Komitetit Qendror të Partisë -

Komiteti Qendror të Partisë vazhdojnë t'i vijnë me mijëra e mijëra letra e telegrame nga gjithë vendi, ku bashkë me dhimbjen e thellë, mbarë populli shpreh ndjenjat e mirënjohjes së pakufishme për Partinë dhe për shokun Enver.

Sapo mori vesh lajmin e kobshëm për vdekjen e Udhëheqësit të lavdishëm të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha, 95 vjeçarja Aishe Runa, nënë dëshmori nga fshati Nivi-

cë-Progonat në rrethin e Tepelenës, vajtoi:
O Enver gjuhë bilbili
(djale o derëzeza)
Me shpatë nxjerr nga milli

Asnjëherë s't'u drodh syri
O Enver me mendje shumë
Natë e ditë s'bëre gjumë
Kalove dallë e furtunë
Kurrë s'e përkule gjunë
Ngrehu Enver bukuria
Se të qan gjithë Shqipëria

Në telegramin e tyre gratë e koo-
(Vijon në faqen 2)



Mbarë populli ynë nderoi me 5 minuta heshtje gjatë varrimit të shokut Enver Hoxha.

(Foto: ATSH)

POPULLI DHE PARTIA NDEROJNE ME MIRENJOHJE TE THELLE VEPREN E PAVDEKSHME TE SHOKUT ENVER HOXHA

Në themelet e pushtetit të popullit



Odrican, 1944

(Vijon nga faqja 1) Shpallim botës vullnetin e lirë të popullit të tij, për të rrojtur i lirë, sovran, me djersën e ballit të vet.

Pranverë e hidhur

Pas Kongresit të Përmetit, për rreth 3 muaj shoku Enver në krye të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare punoi në Odrican, Odricani ishte atë ditë kryeqytet i Shqipërisë së re që po lindte nga gryka e pushkës. Ashtu si ish-ditë më parë Përmeti apo akoma më parë Helmsi, Cermenika e gjer tek ajo shtëpi tiranase ku Enver Hoxha vuri në jetë idenë e madhe të domosdoshmërisë së Partisë Komuniste. Pranverë e hidhur kjo e sivitytmja për Odricanin. Këtu shoku Enver ndejti në shtëpitë e Vitori Jorgjiti dhe Kostandina Londarit. Ato e deshen si nëna, ai i deshi si bir. Kalon anës sofave të kësaj shtëpie dhe një mallëngjim ta zë grykën. Janë po ato gurë të pusit që kanë prekur duart e tij. Po ajo arrë e po ai man i madh në gjelbërimin e të cilëve i çlodheshin sytë pas punëve të rënda. Hyjmë brenda në odë. Ja shtrati ku fjeti. Ulemi në nimat dhe heshtim. Ndezim një duhan. Të duket vetja se ke ardhur për ngushëllim bash në shtëpinë e tij. Këtu punonte ai me atë «olivetin» e tij. Çak-çuk, tërë natën dhe e harronte mënjatë gjellën që i sillte nënë Vitoria. «Kthente kokën nga dera kur hynte njeri dhe çak-çuk vazhonte të shtypte, e letrat i vinte në dosje, thotë Spiro Jani, djali i Vitorisë, atë kohë 14 vjeç djallë. Kur erdhën gjermanët nga Kreshova,

Shtabi doli nga Odricani. Binte shi. Shoku Enver hoqi mushamanë dhe e hodhi sipër mushkës me dokumenta. Tre barrë mushka, kishte me vete». Gjermanët nuk e dogjën Odricanin. Populli e mbrojtë Komandantin e tij dhe Qeverinë e tij të re. Arniku s'e mori vesh vendndodhjen e tyre. Gjermanët dogjën Rabanin dhe Përmetin. Në Rabanin i gjetën një fisek djalit të vogël të Enver Duka. I vunë flakën shtëpisë dhe hodhën edhe djalin brenda. Por Enver Duka, që i lindi tjetër djallë atë ditë, nuk u thye. Kongresi ia vuri emrin. Sot ky Kongres Duka është oficer në flotë dhe pikëllohet për vdekjen e shokut Enver bashkë me të gjithë popullin.

Bisedojmë me Vasil Lacin, brigadier në Odrican dhe anëtar i Ple-numit të Komitetit të Partisë të rrethit «Na njoftuan të zbresim poshtë në Pagri me urgjencë, tregon ai. Morëm mushkat dhe ia varëm. Na mbledhi shoqja Liri, sekretare e Komitetit të Partisë. Kur ç'të dëgjonim... Kështu e kështu tha. Po pse s'na vret më mirë moj shoqja Liri, i thashë dhe sytë m'u errën...». «Ç'të bësh or bir, ... Bulurimë ishte kjo mënyrë» thotë Anastas Janaqi, sekretar i organizatës - bazë të Partisë të Odricani dhe kryetar i këshillit nacionalçlirimtar të fshatit, në kohën kur ishte këtu shoku Enver. «A e njohët atë kohë Enver Hoxhën xha Tatul (kështu e thërrasin)?» «Emrin nuk ja dinim. Komandant i thoshim. Po edhe po të mos na thoshte njeri që ky është Komandanti, dukej ai që atje tej. Bënte ferk. Ky është Komandanti se s'bën, do të thoshe...».

Ai rron tek pushteti i popullit të tij

Në shpatet e Odricani kanë çelur lofatat e bukura ngjyrë alle, bajamet dhe qershitë. Përtej hapet pamja e pyjeve të Alipostvanit dhe e lugeve të Qarishtes. Që aty shoku Enver ruante me dyllbi lëvizjet e forcave gjermane. Po nuk kishte ç'ti bënte as gjermani e as reaksioni Kongresit të Përmetit e vendimeve e tij. Kështu do të shkonte ai fitimtar në Berat in e çliruar e më tej në Tiranën që e priste aq shumë. Kur iku shoku Enver nga Odricani, të tregojnë fshatarët, e ndali Shtabin aty përtej. Iu kthye odricanlinjve dhe i falenderoi ata për gjithçka që kishin bërë për të e për shokët ata muaj. Koço Stefani, mësues patriot nga Odricani i uroi udhë të mbarë e i tha: «E vazhdoftsh kështu si e ke nisur». Dhe ashtu e vazhdoi Komandanti i lavdishëm i Luftës Nacionalçlirimtare dhe Udhëheqësi ynë i paharruar. Se i tillë ishte vullneti i popullit. «Bisedonim me shokët, thotë ai për ato ditë kur shkonte drejt Përmetit, se ç'pasuri të mëdha ka vendi ynë, ç'popull të mrekullueshëm kemi, trim, bujar e punëtor, i cili e meritonte të ishte i lumtur». S'ka zemër të mos ta dritërojnë sot këto fjalë. Për këtë popull shkriu jetën ky komunist i madh e udhëheqës i ndritur. Ai rron në Veprën e tij, që s'e gërryen kurrë erozioni i kohërave. Dhe tek mendon kështu, sytë të shkojnë lart në majat e Dhembellit ku zbardh dëborë e re e natës që shkoj.

BETIM MUÇO

VLORE

«Partia mbi të gjitha!», na tha Enveri në 43-në

- I ka rrënjët të thella në zemrën e të gjithëve shoku Enver Hoxha, thotë veterani Habi Laçaj. Kemi në gjak e në mish, të mëdhenj e të vegjël, mësimet e tij. I thonë afro gjysmë shekulli me të në ballë. I dhamë besën dhe na dha lirinë e jetën. Tri herë u dogj rrafsh Tragjasi, por siç e shikoni, tani është i gjithi i ri. U bë siç tha shoku Enver, ja, mu atje, tek lapidari...

Veterani shtrin dorën mbi shtëpitë e fshatit, në ballë të cilave ngrihet një lapidar i madh. Aty në maj të vitit 1943, shoku Enver Hoxha shpartalloi fraksionin anti-parti, që ishte krijuar në qarkun

e Vlorës. - Aq thjeshtë e kuptueshëm, foli shoku Enver, sa populli i krahinës, që ishte mbledhur aty, thërriste: «Partia mbi të gjitha!». Me gojën e tij aty na premtoi lirinë e na e dha, na premtoi tokën e na e dha, na bëri zotër në vend.

Bukuri e mrekullueshme është Jonufra, me brezare agrumesh e ullinjsh. Mbi një nga këto kodrat, në mars të vitit 1977, shoku Enver u takua e bisedoi me punëtorë, djem e vajza, e me kuadro të NB-së «Rinia». Bahir Balla, që tani është brigadier dhe sekretar i organizatës-bazë të Partisë në Jonufër, kuj-

ton porosinë e Udhëheqësit për të rinjtë atë ditë, që të bëhen bujq të mirë e të nderuar. Të gjithë, sa qemë aty, thotë ai, kujtojmë atë nderimin e lartë, që ruante për njerëzit e punës shoku Enver. Kur i treguam se aty ishte dhe Kozma Nesturi, Hero i Punës Socialiste, Ai e thirri, e vuri pranë vetes dhe u tha të gjithëve: «Xha Kozmai, të dashur shokë, është miku im i vjetër... Ky plak punëtor, specialist i agrumeve, besnik i vijës së Partisë, është dhe besnik i ullinjve. T'i ngrihem në këmbë e ta nderojmë xha Kozmanë».

VANGJEL STEFA

DO TE RROJE NE SHEKUJ ENVERI YNE

(Vijon nga faqja 1)

perativës bujqësore të Krutjes në rrethin e Lushnjës, pasi shprehin hidhërimin për vdekjen e Udhëheqësit dhe mësuesit tonë të shtrenjtë, shokut Enver Hoxha, shkruajnë: Kemi qenë të varfra, të mbyllura e të përbuzura, por Partia e shoku Enver na bënë me krahë, na bënë që ta ndjejmë veten të barabarta përkrah burrave, që ta themi fjalën tonë në të gjitha fushat e jetës. Bashkë me qumështin e gjirit kemi futur në mendje dhe në zemrat e fëmijëve tanë dashurinë për Partinë dhe shokun Enver. Me dashuri nëne u themi fëmijëve se Enver Hoxha nuk do të vdesë kurrë në zemrat tona. Ne kemi Partinë dhe me mësimet e saj dhe të shokut Enver, do të punojmë që ta bëjmë Atdheun më të fortë e më të begatë dhe jetën tonë më të lumtur».

Për mua që kam pasur rastin të takohem disa herë me shokun Enver, thuhet në telegramin e Heroit të Punës Socialiste Riza Burja, hidhërimi është i pamashë. Zemra më është tronditur thellë, por nuk më liqësohet, sepse jeta dhe Vepra e lavdishme e tij, të cilat më kanë ndriçuar përherë rrugën, më bëjnë thirrje që dhimbjen ta kthej në forcë. Nuk do të harroj kurrë ato çaste emocionante të Kongresit të 7-të të Partisë, kur shoku Enver më përqafoi, më ngriti dorën lart dhe tha: «Ja dora e fuqishme e klasës, ja njeriu i mrekullueshëm që ka krijuar Partia». Ngrohtësinë e asaj dore edhe sot e gjithmonë do ta ruaj në zemër, sepse është ngrohtësia dhe kujdesi atëror i Partisë që aq shumë ka bërë për mua traktoristin e thjeshtë».

Emri, figura dhe Vepra e shokut Enver do të mbeten për ne shembull i madh frymëzimi dhe do të na udhëheqin si sot edhe gjithnjë në jetën tonë, shkruajnë mësuesit dhe nxënësit e shkollës së mesme «Ramiz Daci» në Maqellarë të rrethit të Dibrës. Do të punojmë e luftojmë në çdo front të jetës ku ta kërkojnë interesat e atdheut e veçanërisht në kooperativën tonë bujqësore, për të futur më gjerë të rejtat e

shkencës e për të çuar më përpara prodhimin, për ta bërë ekonominë shembull në rreth ashtu siç dëshiron shoku Enver.

Te Vepra e shokut Enver gjejmë forca të pashtershme

Një grup veteranësh, ish-partizanë të krahinës së Martaneshit, shkruajnë se me mallëngjim e përfytyrojnë Udhëheqësin e dashur ashtu si 42 vjet më parë, mes fshatarëve, në shtëpitë dhe kasollet e martaneshave, në ditët e vështira dhe të stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare, kur fliste me atë zë të ëmbël e me ato fjalë të qarta për ditët e lumtura që do të vinin pas fitores mbi armiqtë. Dhe ditët e lumtura erdhën, ato i solli Partia me shokun Enver Hoxha në krye. Shoku Enver nuk ka vdekur, emri dhe Vepra e tij do të rrojnë përjetë në mendjet dhe zemrat tona si dhe të brezave që do të vijnë.

Ne qajmë dhe do ta qajmë me lot shokun Enver, shkruajnë banorët e fshatit Kuç në krahinën e Kurveleshit të Poshtëm, se kështu i qajmë e i vajtojmë ne trimat, me lot dhe me ligje, se na qan e na dhëmb zemra. Por edhe dimë që këtë dhimbje kaq të madhe ta kthejmë në forcë, ta kthejmë në unitet, ta bëjmë flamur betejash e fitoresh në kalanë socialiste, në themelet e së cilës janë mendja, zemra dhe Veprat e shokut Enver Hoxha.

Duke vënë në jetë mësimet e vyerat të shokut Enver Hoxha, thuhet në letërën e komunistëve dhe kooperativistëve të kooperativës së tipit të lartë të Pojanit në rrethin e Korçës, ne e bëjmë realitet dëshirën e tij dhe e shndërruam në kooperativë - flamur të rendimenteve të larta, flamur të përvojës së përparuar në rreth dhe në të gjithë vendin. U nda fizikisht shoku Enver nga ne, por kurrë nga puna dhe jeta jonë, nga zemrat tona. Rron ai tek Partia që e themeloj, tek populli që e rriti, tek veprat që na prijnë, tek mësimet që zbatojmë.

Jemi bij të Enverit

Lajmi i rëndë për vdekjen e Udhëheqësit dhe mësuesit tonë të shtrenjtë, shokut Enver Hoxha, shkruajnë mësuesit dhe nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar «Rexhep Cuni» në Bubq të rrethit të Krujës, na hidhëroi shumë. Dhimbja jonë është e madhe. Jemi lindur e rritur me emrin e Enverit, me fjalët e mësimet e tij. E kemi atë të pranishëm në çdo orë mësimi, në çdo mendim, në çdo përpjekje tonë për dije, për punën, për veprimtarinë tonë të përditshme. Por këtë dhimbje do ta kthejmë në forcë, sepse të fortë na edukoi të qëndrojmë Enveri. Mali i Krujës, kalaja, qëndrojnë të pamposhtur. Enveri është mal mbi malet, kala mbi kalatë, më i larti mal i Shqipërisë. Ne do të luftojmë për të realizuar të gjitha detyrat, që të rritemi ashtu siç dëshiron shoku Enver, të formuar politikisht, ideologjikisht, të kalitur ushtarakisht, me dije të thella shkencore, të aftë për ta çuar më tej stafetën e revolucionit, që atdheu ynë Shqipëria socialiste të jetë përherë e kyqe.

Në letërën e tyre pionierët dhe mësuesit e shkollës 8-vjeçare «7 Nëntori» në Berat, shprehin dhimbjen e thellë për vdekjen e njeriut më të shtrenjtë, Udhëheqësit tonë të dashur e të lavdishëm, shokut Enver Hoxha. Ne, thonë ata, ruajmë në shkollë si kujtimin më të shtrenjtë përshëndetjen aq të ngrohtë, porositë e çmuara dhe fotografitë e xhakit Enver mes pionierëve gurëskalet gjatë vizitës, së 26 shkurtit të vitit 1969. Ajo buzëqeshja e ëmbël, ajo dorë e ngrohtë që na përshëndeste do të mbeten të paharruara në mendjen dhe zemrat tona. Fjalët e tij të zjarrta, dashuria për pionierët dhe punën e tyre, për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e qytetit tonë e të monumenteve të kulturës, do të mbahen të gjalla e të freskëta në mendjen dhe zemrat tona dhe do të na shërbejnë si udhërrëfyes për nismat tona revolucionare. Mësimet e shokut Enver do të hedhin gjithmonë dritë në rrugën tonë.

(ATSH)

POPULLI PER ENVERIN

Redaksisë së gazetës vazhdojnë t'i vijnë me qindra letra, ku përfshihen edhe shumë vargje. Po vazhdojmë të botojmë disa prej tyre.

Na dhe ditë nga të tuat

O e mira natyrë
Si guxon e rrjedh e qetë?
Atij që na hapi sytë,
Ja mbylle sytë për jetë!

Dëshëm të jepnim
ditë nga tonat,
Nuk more asnjë minutë.
Na dhe ditë nga të tuat,
Prandaj Enver nuk vdes kurrë.

SHEFKI HOXHA
Tiranë

Nuk ke vdekë, se rron Partia

Vajtojmë malet, vajton toka
Vajton shqipja me flamur
Ka vdekë shoku Enver Hoxha
Na ka vdekë ma i madhi burrë.

Do t'kujtojmë se na bajn syt
Për 1 Maj, çdo gëzim e festë
Mos je sëmure kemi me pyetë
S'na besohet se ke vdekë.

Nuk ke vdekë se rron Partia
Emrin tënd ka historia
Enver Hoxha përmes vitesh
Kuj si diell veç do rritesh.

OSMAN SHEHU
Kukës

Kam ardhur prapë

(Duke dëgjuar në Televizion intervistën e një mjeku)

Shoku Enver, Shoku Komandant,
Kam ardhur prapë pulsin të të mat.
Kam ardhur që dëgjoj zërin tënd,
dhe zemrën që të rrihte si një këngë.

Kam ardhur dorën në dorë të ta marr,
T'i prek ato deje mbushur me

aq mall.
Kam ardhur të të shoh drejt në sy,
Të rri ballë për ballë, të më shikosh dhe ti.

Dhe të të pyes: «Si je, shoku Enver»
Dhe ti të buzëqeshësh: «Mirë» si përherë.
Pastaj të ngresh vështrimin (mijra luleshqerra),
Të shohësh se ka ardhur pranvera.

Pranvera erdhi, plot lule, shoku Enver,
E solle ti, Partia, gjithë shokët e tjerë,
Por lulet këtë vit do mbajnë peshë të paparë,
Dhimbjen e një populli - kurorë përmbi varr.

Do mbajnë dhe dhimbjen time,
shoku Komandant
Që sot kam ardhur pulsin tim të mat
Të shoh në rreh njësoj me pulsin tënd,
Me pulsin e Partisë. S'ka vdekje për këtë vend.

BARDHYL TOSKA
Tiranë

Kishte popullin te rrënja

Ç'ke, moj shqipe, ç'ke moj Nënë,
Që nuk mbahesh dot në këmbë,
Ç'hall i madh, moj, të ka zënë?
Të përkul peshë e zisë,
Si flamur në gjysëm shtizë...

Ah, moj tokë, ç'do mbash në gji.
Njëmijë male me stuhi,
Sa njëmijë diej e hëna,
Sa njëmijë diej e hëna,
Enver Hoxhë s'bën më nëna!

Se s'kish gjak, po prush në rrëmba,
Se kish diell në sy brenda,

Vetëtimë kish te këmba,
Kishte popullin te rrënja.

Në porta dalin anetë,
Jo, jo, s'është e vërtetë,
Në shërbim u nis një natë,
S'ka si të mos vijë prapë,
Se e kishim jetëgjatë,
Ashtu si malet e lartë!...

Po gjëmon shqipja me nure,
Flet çdo zemër, gur e lule,
Enver merak mos të mbetet,
S't'i harrojmë amanetet,
Sa të ketë shqipnja jetë,
Emrin, veprën, jo s'ta tret.
Është Partia mal në këmbë,
Është një popull zemërshekëmb.

ARBEN DUKA
Gjirokastrë

I gjallë përmbi të gjallë

A ka burrë, që rri në këmbë
Kur ka n'sup këtë peshë të rëndë?
Kush e ngre në krah ylberin,
Ç'dorë e fut në dhë Enverin?

Jo, mor, jo, ai s'ka vdekur,
Toka nënë s'ka për ta tretur,
S'e tret dot këtë trim të rrallë,
Është i gjallë përmbi të gjallë.

GJOVALIN TOTRI
Malaj-Mirditë

Vepra e tij burim i forcës

Ç'kanë pamët pse s'gëthojnë
Ç'kanë lulet pse erë s'lëshojnë
Ç'kanë zogjtë pse s'fluturojnë
Enver Hoxha s'është më
I bukuri bilbil me zë.

Çohu, Enver, e mos rri rënë
Mal mbi mal të duam në këmbë
S'luajmë nga rruga e së vërtetës
Emri Enver, dielli i jetës
Vepra e tij burim i forcës
Na jep krahët e shqiponjës.

PIRO RESULI
Drashovicë-Vlorë

POPULLI DHE PARTIA NDEROJNE ME MIRENJOHJE TE THELLE VEPREN E PAVDEKSHME TE SHOKUT ENVER HOXHA

GJIROKASTER

Rron sa qyteti ynë i gurtë që e lindi

C'të themi, dhimbjen e kemi të madhe, sa ç'e di populli vetë. Shtëpitë tona janë hapur e presin ngushëllime, kurse në Shtëpinë ku lindi shoku Enver nuk mbaroi lumi i njerëzve që vijnë të shohin, për të sjatën herë vallë, vatrën ku tha «mëmë» dhe «mëmëdhe». Në odanë e madhe anetë e lagjes, të Dunavitit e Manalalit, Kardhiqit e Dropullit, Lunxhit e Zagorisë qajnë me botë e me ligje. Qajnë e si mbaruan fjalët e gjuhës.

Në lagjen tonë u lind, u rrit e

mori mësimet e para revolucionare Udhëheqësi dhe mësuesi i popullit dhe i Partisë shoku Enver Hoxha. Nën atë baballarët tanë e rritën. Ata e përcollën në udhët e Shqipërisë për t'i gjetur asaj udhën e vërtetë.

Emri i Palortosë, emri i Gjirokastrës sonë, është i pandarë nga emri dhe figura e shokut Enver. Çdo gjë, kudo hedhim sytë na kujton Enverin, na kujton buzëqeshjen e tij, fjalët e ngrohta, bisedat nëpër sokake, porositë dhe këshillat e

gmuara, shakatë.

Dhimbje si kjo çan edhe gurin, por na duhet të jemi më të fortë se guri, se shoku Enver vetë na ka mësuar të jemi të tillë, na ka treguar si të bëhemi të tillë.

Këto fjalë dëgjon në këto ditë të rënda në Palorto e Hazmurat, Cfaqë e Dunavat, në tërë Gjirokastrën.

FETAH HOXHA, HAZIZE DO-RACI, QERIM SHERIFI, MAKSIM BAKIRI,
Palorto, Gjirokastrë

DIBER

ME ÇFARE MATET TRONDITJA

- Qaj moj bijë, qaj, i thotë sot nënë Hasija, Afërdita Gjoni në Maqellarë. Enveri të ka ardhur te kryet kur ti ishe në djep.

Ç'është kështu? Dhimbja sa vjen e rritet, fryhet nga lotët, siç fryhen lumenjtë nga shkrija e deborës në kreshpa. Dibranët e kanë si tani parasysh, të dashurin shokun Enver, kur erdhi mes deborës e acarit në ato ditë të tërmetit, të dhjetorit të 67-tës, t'u japë zemër, të përballojë fatkeqësinë.

- Ah ç'fjalë t'ambala kishte, thotë Miftari, i zoti i shtëpisë. Vajzën e kisha në djep. Edhe qante. Kurse vajza e shokut Enver, Pranvera, kishte hipur mbi çatinë e shtëpisë time duke punuar. E kisha merak se mos ma gjen gjë, se mos më rrëzohet nga çatia, i thosha: Zbrit nga çatia, shko e ngrohu tek zjarri. Po e kishte çue Enveri, e kishte porositë Enveri me punue si gjithë të tjerët. E prandaj ajo nuk i afrohej zjarrit të ngrohej.

- Edhe djemtë i kishte çue me na ndihmue, vazhdon Nuri Gjoni. E ku gjen njeri në botë të ta qajë hallin si ta qante Enver Hoxha?

Ndoshta sepse vizita e fundit në Diber e Udhëheqësit tonë të lavdishëm shokut Enver lidhet me ato

ditë të tërmetit, prandaj kjo humbje madhore lëviz nga biseda në bisedë si një tërmet. Dhe populli tërmetet në epokën e Partisë, sipas mësimet të shokut Enver i ka përballuar me unitetin e çelikut rreth Partisë. Kështu që edhe këtë të fundit, tërmetin e humbjes së njeriut më të dashur të zemrave, Enverin, kështu po e përballon.

- Shtëpia më që shembur atëhere, tetë fëmijë kisha, thotë Bajram Muça në Vojnik. Më thanë se do të vijë për vizitë shoku Enver. O fati i madh, thashë, po ku ta fus, se ç'binte jashtë binte brenda. Udhë nga do të vinte ishte gjithë baltë. Se kush i tha Udhëheqësit të ecte mbi ca gurë, që të mos bëhej me baltë. «Për ne shqiptarët, tha shoku Enver, këmba në baltë është si kafshata në mjalte».

- Lëre, lëre mos e nga... Po kur më tha kur erdhi tek ftoi, pa hyrë brenda në mbetet pak hatiri, por për të hyrë brenda në shtëpi le të na prijë e zonja e shtëpisë. Hajde o Enver nuri, thashë me vete, më thotë «shoku Bajram». Po ç'isha unë? Hallemadhi, që ma mori hallin Enveri. E çaj te njerëzit veç gëzim...

SAMI MILLOSHI

Nënshkrimi i dhimbjes

- Mbresa -

Në dhomën e telegrafistëve në PT-në e Korçës në ditë të zakonshme është e ndaluar të hysh, por këto ditë njerëzit nuk durojnë të presin tek sporteli ku lexohet: «Telegrame». Ngjiten lart aty ku teleksat zhurmojnë nga dhimbja... Kanë merak, duan fjalët e dhimbjes dhe zemrave të bashkuara të shkojnë sa më parë tek shokët besnikë të Enverit, tek të afërmit. Teleksat kërcasin e nuk pushojnë.

Çfarë po bëjmë kështu. Çfarë po shkruajmë? Me këto duar kemi nisur urime për përvjetorët e lindjes së Udhëheqësit, i kemi nisur siharë, kemi nisur betimet e punës, të kooperativistëve, të rinjve, vjershat e zemrës së fëmijëve... Dhe kemi thënë të gjithë: «Sa malet të jetojë». Telegrafistët shikojnë njëri-tjetrin në sytë e rënduar nga lotët e dhimbja.

Punojnë telegrafistët, pa kuptuar kufitë e ditës dhe të natës, punojnë dhe me vete zgjedhin fjalët që do të shkruajnë vetë ata në telegramin që do të bëjnë. Populli shkruan dhimbjen kombëtare.

KOSTAQ DUKA

SKICE

NE FLETOREN ME FJONGON KUQ E ZI



«...zemra e Partisë është një zemër shumë më e madhe se zemra e një nëne të vetme, ajo është një zemër bujare, që kujdeset për të gjithë popullin».
(Shtëpia e fëmijës «8 Nëntori» Tiranë, nëntor 1969)

Në Komitetin e Rinisë të rajonit nr. 2, në Tiranë, kompania e pionierëve të shkollës «Alqi Kondi» ka dërguar një fletore të lidhur me fjongo kuq e zi. Çdo pionier ka shkruar aty fjalë zemre. Dikush për takimin që ka patur me shokun Enver, një tjetër në poezi, një betim, një prematim...

«Sy i fëmijës pse loton?/ xhaxhi Enveri më nuk rron» shkruan pionierja Arjana Zeneli. «Ti jeton unë e di. Jeton në zemrën time, të të gjithë fëmijëve, në zemrën e popullit që e deshe aq shumë. Jo! Unë s'mund ta besoj. Ti jeton», janë fjalët e pionierit Altin Roshini.

Asnjëri nuk e beson se xhaxhi Enver i nda përgjithmonë. Nuk donin ta besonin as vogëlushët e klasës së pestë të shkollës «1 Qersho-

ri». Kur morën vesh se Ai mbylli sytë, edhe pse mësimi mbaroi, nuk u larguan në shtëpi. Rrinin në klasë e qanin mbi banga, përballë portretit. Një pioniere u ngrit e shkroi në tabelë «Jo, xhaxhi Enveri nuk vdes», dhe, në mes të ngashërimit, e gjithë klasa ia nisi në kor të recitonte vargjet e këngës «Enver Hoxha, tungjatjeta».

Mëngjesi i datës 12 prill bustin e Udhëheqësit të dashur në shkollën «8 Nëntori» e gjeti të rrethuar me lule të freskëta. Një pioniere donte që medoemos aty të kishte trëndafila të kuq. E la një orë mësimi dhe shkoi e gjeti një buqetë të madhe trëndafilash. «Pionierët erdhën shumë më herët se ditët e tjera dhe ishin vendosur për të bërë roje nderi. Ndërgjegjja u tha.

SEJDIN CEKANI

Me Shqipërinë lartësohet figura, Vepra dhe forca vigane e shokut Enver Hoxha

- Telegrama ngushëllimi nga shoqëritë patriotike -

Në telegramin e dërguar nga shoqëria patriotike «Skënderbeu» e Argentinës, shkruhet:

Të dashur vëllezër,

Me hidhërim të thellë mësuam vdekjen e Udhëheqësit të madh të popullit tonë, njeriut më të dashur të zemrave tona, shokut Enver Hoxha.

Të mbledhur së bashku në Shoqërinë Patriotike, «Skënderbeu», këtu në Argentinë, larg mëmëdheut, ne e ndiejmë shumë thellë këtë humbje, kujtojmë dhe mëndojmë për çastet që kalon Atdheu, për momentet aq të rënda të vëllezërve dhe motrave tona. Nuk ka, vëllezër e motra të dashura, shqiptarë e shqiptare të ndershëm, që të mos jetojë këto ditë me kujtimet e mbresat e pashlyeshme që kanë lënë veprat dhe mësimet e shokut të dashur Enver. Kthejmë sytë nga Shqipëria dhe shohim se si lartësohet bashkë me të figura dhe vepra e tij, se si janë përjetësuar forca vigane dhe energjitë e shokut Enver.

Në festën e madhe të 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut ai na e drejtoi Përhëndetjen e përkshuar nga

ndjenja e tij e ngrohtë, këshillat e dashura, optimizmi dhe guxim për të çuar më përpara fitoret, për të çelikusur vendin. Përhëndetja e shokut Enver, na mbush zemrat me gëzim, na rrit ndjenjën e lartë të atdhedashurisë, për të bërë më shumë për vendin tonë.

Të dashur shokë,

Për ne shoku Enver rron e do të rrojë në shekuj. Ai është në çdo shtëpi, në çdo zemër shqiptari, i pranishëm në çdo bisedë, në çdo veprimtari, në çdo gëzim dhe vështirësi. Sepse ai na mësoi të duam njëri-tjetrin, të përqijem për të mirën e përbashkët, ta ngremë më lart vendin dhe lavdinë e tij.

Vëllezër të dashur,

Në këto çaste të vështira e tepër të rënda ne përsëri kujtojmë këshillat e urta e të dashura të shokut Enver, ta kthejmë dhimbjen në forcë. Bëhuni të fortë ju, shtrëngoni radhët sikurdoherë që të na jepni edhe ne kurajo e zemër. Të qëndrojmë e të ecim sëbashku siç na dëshiroi e si na la Mësuesi ynë i madh dhe Udhëheqësi i lavdishëm: Të bashkuar si një trup i vetëm, me Partinë në ballë, me zemër e me kurajo

për të mos u tërhequr kurrë prapa, por kurdoherë në sulm, kurdoherë në fitore.

Vëllezër dhe motra,
Sa momente të vështira e drama të mëdha kaloi Udhëheqësi ynë, sa beteja drejtoi dhe fitoi ai së bashku me ju, sa forca i dhatoj ju atij në luftën e egër kundër armiqve e tradhtarëve. Me këto përballoni edhe këtë dhimbje dhe kurrë mos u ligëstsoni. Qëndroni si Skënderbeu, qëndroni si Enveri.

Të rrojtë Partia, Të rrojtë populli shqiptar!

Të rrojtë në shekuj puna dhe vepra e shokut Enver Hoxha.

Për shoqërinë «Skënderbeu»,
Kryetari Haxhi Dervishi,
Sekretari Horacio Ramadan
Buenos Aires, më 15 prill 1985

Në telegramin e dërguar nga shoqëria patriotike «Shqipëria e Lirë» e Australisë shkruhet:

«Lajmi i hidhur që mësuam na preku thellësisht. Anëtarët e Shoqërisë i shprehin me gjithë zemër ngushëllime të thella familjes së Udhëheqësit, Partisë dhe popullit shqiptar. Lavdi shokut Enver».

Dhimbja jonë është njësh me atë të të gjithë popullit shqiptar

- Telegrama nga shqiptarë e bashkëatdhetarë me banim jashtë Atdheut -

Komiteti Qendror të Partisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë i kanë ardhur këto ditë shumë letra e telegrame nga shqiptarë e nga bashkëatdhetarë me banim në vende të ndryshme të botës, në të cilat shprehet dhimbja e tyre e thellë për vdekjen e Udhëheqësit të Partisë e të popullit tonë, shokut Enver Hoxha.

Me fjalë zemre, shqiptarët e bashkëatdhetarët e cilësojnë vdekjen e shokut Enver si një humbje të madhe për të gjithë kombin shqiptar dhe me këtë rast shprehin pikëllimin e tyre të thellë dhe ngushëllimet e tyre për Partinë dhe Komitetin e saj Qendror, për popullin dhe familjen e shokut Enver Hoxha. Me këtë rast ata ngrënë lart figurën e shokut Enver, jetën dhe veprën e tij të pavdekshme, rolin e tij të madh si themelues e Udhëheqësi i Partisë dhe i shtetit të ri shqiptar, si marksist-leninist i shquar dhe strateg i papërkulur i revolucionit.

Me dhimbje të pakufishme në zemër, shkruajnë një grup shqiptarësh me punë në Zvicër, morëm lajmin e hidhur se u nda nga ne Udhëheqësi i lavdishëm i Partisë dhe i

popullit shqiptar, shoku Enver Hoxha.

Shoku Enver, theksojnë ata, u shkri si qiriri gjatë më se gjysëm shekulli, për t'i ndritur rrugën popullit shqiptar drejt lirisë, pavarësisë dhe socializmit. Ai luftoi heroikisht kundër pushtesit fashist e tradhtarëve, kundër armiqve të revolucionit.

Në këto çaste hidhërimi të madh për humbjen e birit më besnik të kombit tonë, shkruajnë një grup shqiptarësh me banim në Nju-Jork, dhimbja jonë është njësh me atë të të gjithë popullit shqiptar. Emri dhe vepra e shokut Enver Hoxha do të mbeten të pavdekshme. Pikëllimi, venë në dukje ata, na lehtësohet se shoku Enver vdiq i mbuluar me lavdi dhe e la Shqipërinë kala të pashlyeshme, të lulëzuar e të përparuar, të fuqishme si asnjëherë në historinë e saj mijëra vjeçare.

Ashtu si juve, shkruajnë një grup shqiptarësh me punë në Republikën Federale Gjermane, edhe neve na therën zemrat. Në zi, thonë ata, nuk është vetëm populli shqiptar, por i gjithë kombi, të gjithë shqiptarët e ndershëm kudo që jetojnë e punojnë në botë.

Brez pas brezi do ta kujtojmë me nderim e respekt të veçantë shokun Enver Hoxha dhe veprën e tij. Ai do të mbetet i paharruar në mendjet dhe zemrat tona, shkruajnë një grup shqiptarësh me punë në Danimarkë. Shoku Enver Hoxha, nënvizojnë ata, ishte jo vetëm Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar, por edhe internacionalist i vërtetë. Ai e bëri Shqipërinë të fortë që do të rrojë gjithmonë e lirë dhe e pavarur.

Bashkë me dhimbjen e thellë të tyre, shqiptarë e bashkëatdhetarë, shprehin edhe besimin e tyre të pamtundur, se vepra e shokut Enver Hoxha do të rrojë në shekuj, se ajo mbetet e pavdekshme.

Vepra e Enver Hoxhës do të rrojë për jetë në zemrat tona. Ajo është fanar i pashuar në rrugën e revolucionit, shkruajnë një grup bashkëatdhetarësh dhe shumë shqiptarë me banim në Lozanë e në Bruksel. Do të jemi, venë në dukje ata, kurdoherë me Partinë e Punës të Shqipërisë, me mësimet dhe veprën e shokut Enver Hoxha, do të ecim kurdoherë me besim në rrugën e tij, që është rruga e nderit dhe e lavdisë së kombit tonë.

(ATSH)

Një nga personalitetet më të shquara të botës në epokën tonë

- Nga telegramet e ngushëllimit dërguar nga shoqatat e miqësisë -

Komiteti Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i kanë ardhur telegrame nga shoqata të miqësisë me vendin tonë, në të cilat shprehen ngushëllimet e singerta dhe ndjenjat e miqësisë për popullin e Partinë tonë.

Në telegramin e kryesisë së Shoqatës së Miqësisë Brazil - Shqipëri shkruhet:

«Me hidhërim të madh morëm lajmin tronditës për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Udhëheqësi i popullit shqiptar, marksist - leninist i madh, burrë shteti dhe një nga personalitetet më të shquara të botës në epokën tonë. Për ne, miqtë e popullit shqiptar e të Shqipërisë Socialiste, vdekja e shokut Enver Hoxha është një humbje e thellë. Lutemi i transmetoni popullit shqiptar dhe familjes së shokut Enver ngushëllimet tona të thella.

Të frymëzuar nga jeta, vepra dhe mësimet e shokut Enver Hoxha, ne do të vazhdojmë punën dhe luftën tonë për forcimin e lidhjeve vëllazërore dhe miqësore midis popullit brazilian dhe popullit shqiptar».

Në telegramin e dërguar nga kryetari i Shoqatës së Miqësisë Egjipt-Shqipëri, Profesor dr. Naguib Abu Leil, shkruhet:

Në emër të të gjithë anëtarëve të Shoqatës së Miqësisë Egjipt - Shqipëri ju shpreh keqardhjen tonë për humbjen shumë të hidhur të shokut tonë të madh dhe shumë të dashur, Enver Hoxha.

Ne jemi të sigurtë se ai do të mbesë gjithmonë i gjallë në zemrat e të gjithë shqiptarëve dhe të miqve të tyre, në të gjithë botën. Ne nuk do të harrojmë kurrë Enver Hoxhën e pavdekshëm që çliroi vendin e tij, e ndërtoi nga fillimi dhe e bëri të pavarur, të fortë e të lulëzuar.

Enver Hoxha ka lënë pas vetes një ushtri të tërë të madhe nxënësish të singertë, të ndershëm e besnikë të ideve të tij, të mësimet e të parimeve të tij.

Në këtë cast historik le të mposhtim dhembjen, lotët dhe keqardhjen dhe të thërrasim të gjithë: «Rroftë Shqipëria!».

Pranoni, zotërinj, sigurimet tona më të shtrenjta.

Në telegramin dërguar nga Shoqata e Miqësisë Japoni - Shqipëri shkruhet:

Me rastin e vdekjes së Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha, të gjithë anëtarët e Shoqatës së Miqësisë Japoni - Shqipëri shprehin nga zemra ngushëllimet e tyre.

Nën Udhëheqjen dhe sipas mësimet të shokut Enver Hoxha, Partia dhe populli shqiptar korri fitoren e shkëlqyer historike dhe u kanë dhënë frymëzimin e madh proletariatit e popujve të botës.

Populli shqiptar do të luftojë pa ndërprerë për çështjen e madhe për

të cilën ka luftuar deri më sot.

Betohemi se do të mësojmë nga jeta e madhe revolucionare dhe vepra e ndritur e shokut Enver Hoxha, do të zhvillojmë lëvizjen e miqësisë dhe solidaritetit midis popujve të Japonisë e Shqipërisë duke e kthyer hidhërimin në forcë.

Në telegramin e grupit të Miqësisë Meksikë-Shqipëri ndër të tjera shkruhet:

«Me hidhërim të thellë mësuam për vdekjen e të dashurit dhe të admirueshmit tonë shokut Enver Hoxha, Udhëheqësi të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, heroit të rezistencës antifashiste, themeluesit të Partisë dhe të Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe arkitektit të Shqipërisë Socialiste. Vdekja e tij është një humbje e madhe jo vetëm për Partinë dhe popullin shqiptar por edhe për të gjithë popujt e botës.

Në telegramin e grupit të Miqësisë Spanjë - Shqipëri shkruhet: «Ju dërgojmë ngushëllimet tona për vdekjen e shokut Enver Hoxha. Kemi besim në energjinë e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar».

Në telegramin e Shoqatës së Miqësisë Portugal - Shqipëri ndër të tjera shkruhet:

«Për vdekjen e shokut Enver Hoxha ju dërgojmë ngushëllimet e singerta».

VLERESIM I LARTE E MIRENJOHJE E THELLE PER ROLIN E SHOKUT ENVER HOXHA NE LUFTEN PER ÇESHTJEN E LIRISE, PAVARESISE DHE PERPARIMIT SHOQEROR NE BOTE

PARTI DHE PERSONALITETE SHTETERORE DHE POLITIKE TE BOTES VAZHDOJNE TE DERGOJNE NGUSHELTIME ME RASTIN E VDEKJES SE SHOKUT ENVER HOXHA

Komiteti Qendror të Partisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shokut Ramiz Alia, Sekretar i Parë i KQ të PPSH-së e kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe shokut Adil Çarçani, kryetar i Këshillit të Ministrave, vazhdojnë t'u vijnë telegrame nga parti, kryetarë shtetesh, kryeministër, organizata dhe personalitete të ndryshme politike e shoqërore, në të cilat shprehen ngushëllime e shqetësimet dhe ndjenjat e simpatisë me rastin e vdekjes së udhëheqësit të Partisë e të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nga Komiteti Qendror i Partisë Popullore Revolucionare të Laosit, Asamblea e Lartë Popullore dhe Kryesia e Këshillit të Ministrave të Republikës Demokratike Popullore të Laosit, shkruhet:

Komiteti Qendror i Partisë Popullore Revolucionare të Laosit, Asamblea e Lartë Popullore dhe Kryesia e Këshillit të Ministrave të Republikës Demokratike Popullore të Laosit, shprehin ngushëllime të tyre të sinqerta për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Vepra madhështore e shokut Enver Hoxha - shembull i madh për popujt

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia nga kryetari i Këshillit Kombëtar të Revolucionit, president i Burkina Fasos, kapiten Tomas San-kara shkruhet:

Me një dëshpërim dhe dhimbje shumë të madhe morëm lajmin e hidhur të vdekjes të shokut Enver Hoxha.

Në këtë provë të rëndë, jam ngarkuar nga populli i Burkina Fasos dhe Këshilli Kombëtar i Revolucionit t'u dërgoj Juve, gjithë popullit shqiptar dhe familjes së tij, ngushëllime me të dhimbshme dhe me të thella. Vdekja mizore rrëmbëu në mënyrë të papritur shokun Enver Hoxha në momentin kur forcat përparimtare kanë drejtuar shikimin admirues dhe vëmendjen e tyre drejt Shqipërisë socialiste dhe udhëheqjes së saj të ndritur.

Ne do të ruajmë gjithmonë këtë vepër kaq të mirë dhe shpëtimtare jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për të gjithë popujt paqdashës që luftojnë për drejtësi.

Populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e Punës së Shqipërisë, me në krye shokun Enver Hoxha, ka realizuar transformime madhështore revolucionare në fushën politike, ekonomike, shoqërore e kulturore dhe në fusha të tjera të jetës së vendit. Me fitoret e mëdha dhe të rëndësishme vepra e Enver Hoxhës i dha fund njëherë e përgjithmonë shtypjes e shfrytëzimit të masave të gjera të popullit dhe i siguroi një zhvillim të shpejtë e të pandërprerë ven-

dit dhe popullit shqiptar, duke i çuar e ngritur me lart traditat e shkëlqyera patriotike dhe revolucionare.

Vepra madhështore e Shqipërisë socialiste të Enver Hoxhës është një shembull i madh për popujt që luftojnë për paqe dhe drejtësi, sepse ajo u lidh ngushtë me luftën për liri e pavarësi, me luftën kundër klasave shfrytëzuese, me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, me mbrojtjen e Atdheut socialist kundër qëllimeve dhe intrigave djallëzore dhe armiqësore të imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre, sepse ajo u lidh ngushtë me vendosjen e diktaturës së proletariatit, me zhdukjen e çdo shfrytëzimi, me ndërtimin e socializmit si dhe me vendosjen e konsolidimin e një aleance të çeliktë të klasës punëtore me fshatësinë punonjëse dhe masat e tjera popullore.

Jemi të bindur se me humbjen e Udhëheqësit të madh të Partisë dhe të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha, nuk do të ndërpritet marshimi fitimtar i Shqipërisë socialiste dhe vija e drejtë e Partisë së lavdishme të Punës, të themeluar e kalituar nga shoku Enver Hoxha, do të garantojë si gjithnjë fitoret e vazhdueshme të popullit vëlla shqiptar.

Ju lutemi, shoku kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, pranoni shprehjet e simpatisë sonë të sinqerta.

Atdhe ose vdekje. Ne do të fitojmë!

Në telegramin dërguar shokut Adil Çarçani nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të Rimëkëmbjes Kombëtare, Kryetar i Shtetit, President i Republikës së Guineës, Koloneli Lansana Konte, shkruhet:

Në emër të qeverisë Federale të Austrisë, si dhe në emrin tim, ju lutem pranoni ngushëllime tona të sinqerta me rastin e vdekjes së Shkëlqesë së tij, Enver Hoxha.

Me vdekjen e tij Shqipëria humbi një personalitet, i cili përcaktoi fatin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për disa dhjetëvjeçarë, dhe që ka hyrë në historinë e Evropës.

Në telegramin dërguar shokut Adil Çarçani nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të Rimëkëmbjes Kombëtare, Kryetar i Shtetit, President i Republikës së Guineës, Koloneli Lansana Konte, shkruhet:

Komiteti Ushtarak i Rimëkëmbjes Kombëtare dhe Qeveria e Republikës së Guineës mësuam me dhimbje të thellë për humbjen e rëndë që pësoi vendi juaj me vdekjen e Shkëlqesë së tij Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ne përlumi përpara kujtimit të këtij njeriu të shkëlqyer, i cili gjatë gjithë jetës së tij u qëndroi besnik idealeve të drejtësisë, paqes dhe çlirimit të popujve. Populli i Guineës dhe Qeveria e tij që kanë marrëdhënie të shkëlqyera miqësive me popullin dhe Qeverinë Shqiptare e ndjejnë thellë këtë goditje të rëndë që pësoi populli mik shqiptar.

Në këtoaste hidhërimi të thellë ju lutemi të pranoni, Zoti Kryetar i Këshillit të Ministrave, ngushëllime tona të sinqerta që i shprehim të gjithë popullit shqiptar, qeverisë së tij dhe familjes së tij.

Me konsideratë shumë të lartë.

Shokut Adil Çarçani i kanë ardhur këto telegrame nga kryetarë qeverish:

Në telegramin dërguar nga Kryeministri i Japonisë, Jasuhiro Nakasone, shkruhet:

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia, nga Presidenti i Republikës Islamike të Pakistanit, gjeneral Mohamed Zia Ul Hak, shkruhet:

Në emër të qeverisë dhe të popullit të Pakistanit, si dhe në emrin tim, i shpreh Shkëlqesë Suaj ngushëllime tona të thella për vdekjen e hidhur të Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Gjatë periudhës së tij të gjatë në udhëheqje të Partisë së Punës të Shqipërisë, Sekretari i Parë u bëri shërbime të paçmuara vendit të tij

dhe popullit shqiptar.

Bashkohemi me popullin e Shqipërisë duke mbajtur zi për humbjen e udhëheqësit të tij të shkëlqyer.

I lutem Shkëlqesë Suaj që t'i shprehë familjes së tij të pikëlluar ndjenjat tona të sinqerta.

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia nga kryetari i Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Polonisë, Henrik Jablonski, shkruhet:

Në emër të Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Polonisë si dhe në emrin tim vetjak ju dërgoj shprehjen e ngushëllimit të thellë për vdekjen e shokut Enver Hoxha.

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia, nga Udhëheqësi i Revolucionit Libian, Muamar Kadafi, shkruhet:

Në emrin tim dhe në emër të popullit libian ju dërgojmë ngushëllime tona më të sinqerta për vdekjen e Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ju lutem që këto ngushëllime t'ia transmetoni popullit shqiptar dhe familjes së tij.

Në telegramin dërguar Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga

Personalitet që ka hyrë në histori

Në telegramin dërguar shokut Adil Çarçani nga Kancelari Federal i Republikës së Austrisë, Fred Sinovac, shkruhet:

Në emër të qeverisë Federale të Austrisë, si dhe në emrin tim, ju lutem pranoni ngushëllime tona të sinqerta me rastin e vdekjes së Shkëlqesë së tij, Enver Hoxha.

Me vdekjen e tij Shqipëria humbi një personalitet, i cili përcaktoi fatin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për disa dhjetëvjeçarë, dhe që ka hyrë në historinë e Evropës.

Në telegramin dërguar shokut Adil Çarçani nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të Rimëkëmbjes Kombëtare, Kryetar i Shtetit, President i Republikës së Guineës, Koloneli Lansana Konte, shkruhet:

Komiteti Ushtarak i Rimëkëmbjes Kombëtare dhe Qeveria e Republikës së Guineës mësuam me dhimbje të thellë për humbjen e rëndë që pësoi vendi juaj me vdekjen e Shkëlqesë së tij Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ne përlumi përpara kujtimit të këtij njeriu të shkëlqyer, i cili gjatë gjithë jetës së tij u qëndroi besnik idealeve të drejtësisë, paqes dhe çlirimit të popujve. Populli i Guineës dhe Qeveria e tij që kanë marrëdhënie të shkëlqyera miqësive me popullin dhe Qeverinë Shqiptare e ndjejnë thellë këtë goditje të rëndë që pësoi populli mik shqiptar.

Në këtoaste hidhërimi të thellë ju lutemi të pranoni, Zoti Kryetar i Këshillit të Ministrave, ngushëllime tona të sinqerta që i shprehim të gjithë popullit shqiptar, qeverisë së tij dhe familjes së tij.

Me konsideratë shumë të lartë.

Shokut Adil Çarçani i kanë ardhur këto telegrame nga kryetarë qeverish:

Në telegramin dërguar nga Kryeministri i Japonisë, Jasuhiro Nakasone, shkruhet:

Në telegramin dërguar shokut Ramiz Alia, nga Presidenti i Republikës Islamike të Pakistanit, gjeneral Mohamed Zia Ul Hak, shkruhet:

Në emër të qeverisë dhe të popullit të Pakistanit, si dhe në emrin tim, i shpreh Shkëlqesë Suaj ngushëllime tona të thella për vdekjen e hidhur të Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Gjatë periudhës së tij të gjatë në udhëheqje të Partisë së Punës të Shqipërisë, Sekretari i Parë u bëri shërbime të paçmuara vendit të tij

Sekretari i Parë dhe Presidenti i Bashkimit Kombëtar Afrikan të Zimbabvesë (Fronti Patriotik) dhe Kryeministër i Republikës së Zimbabvesë, Robert Gabriel Mugabe, shkruhet:

Të dashur kolegë dhe shokë, Me tronditje dhe hidhërim shumë të thellë mësuam për vdekjen e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në emër të Bashkimit Kombëtar Afrikan të Zimbabvesë (Fronti Patriotik), të Qeverisë dhe të popullit të Zimbabvesë, si dhe në emrin tim ju shpreh keqardhjen tonë më të thellë për humbjen tragjike të themeluesit dhe udhëheqësit të madh e të shtrënjtë të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Shoku Enver Hoxha do të mbetet i paharruar për kujdesin e tij të vazhdueshëm për mirëqenien e popullit punonjës të Shqipërisë dhe për urrejtjen e tij ndaj çdo formë shtypjeje, shfrytëzimi dhe nënshtrimi të njeriut nga njeriu. Mbështetja dhe frymëzimi që ai i dha popullit të Zimbabvesë gjatë Luftës së tij për çlirim do të mbahet mend përherë.

Në këtoaste pikëllimi, pranoni, ju lutem, të dashur kolegë, siguri- met e konsideratës sime më të lartë.

Me pikëllim të thellë mësova lajmin e vdekjes së Shkëlqesë së tij, Zotit Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në emër të Qeverisë dhe të popullit të Japonisë, pranoni, ju lutem, ngushëllime të mia të sinqerta.

Në telegramin dërguar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga sekretari i Përgjithshëm i Partisë Revolucionare të Tanzanisë, Rashid Kavaja, shkruhet:

Me dhimbje dhe hidhërim të thellë mësuam lajmin për vdekjen e parakohëshme të shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Në emër të Komitetit Ekzekutiv Kombëtar të Partisë Revolucionare të Tanzanisë dhe në emrin tim personal ju dërgojmë juve dhe nëpërmjet jush komunistëve shqiptarë, gjithë popullit shqiptar dhe familjes së tij ngushëllime dhe simpatinë tonë më të thellë.

Ne njohim kontributin e madh të dhënë nga shoku Enver Hoxha në krye të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar, në zhvillimin e popullit shqiptar, në mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe në luftën e popujve të shtypur e të kolonizuar në të gjithë botën.

Në veçanti ne kujtojmë përpjekjet e tij të palodhura në çuarjen përpara të çështjes së socializmit dhe në luftën kundër imperializmit shoqëror.

Prandaj, me vdekjen e shokut Enver Hoxha ndjen një humbje të madhe jo vetëm komunistët dhe popullit shqiptar, por edhe Partia Revolucionare e Tanzanisë dhe popujt tanzanianë, si dhe të gjithë ata që mbajnë lart flamurin e antiimperializmit, socializmit dhe përparimit botëror.

Duke shprehur dhimbjen tonë më të thellë, ne mbajmë zi së bashku me ju për vdekjen e shokut Enver Hoxha.

Partisë Popullore Revolucionare, të Këshillit të Shtetit, të Asamblesë Kombëtare, të Këshillit të Ministrave, sot në mbarë Kamboxhia u shpall zi kombëtar. Në të gjitha institucionet publike kamboxhiane flamuri u ngrit në gjysmë shtize dhe u ndërpre në të gjitha veprimtaritë kulturore.

(ATSH)

HOMAZHE PER VDEKJEN E SHOKUT ENVER HOXHA NE PERFAQESITE TONA DIPLOMATIKE JASHTË SHTETIT

Me rastin e humbjes së madhe për kombin tonë, vdekjes së udhëheqësit të dashur të Partisë dhe të popullit tonë, shokut Enver Hoxha, në të gjitha përfaqësitë dhe misionet diplomatike të RPS të Shqipërisë jashtë shtetit, u hap Libri i Ngushëllimeve. Shumë personalitete politike, shoqërore, miq e dashamirës të vendit tonë në vendet e ndryshme të botës, përfaqësues të partive marksiste-leniniste, shqiptarë në emigracion, etj., kanë shkruar në ambasadat tona për të shprehur ngushëllime të tyre.

Në ambasadën tonë në Hanoi shkuan për të shprehur ngushëllime për vdekjen e shokut Enver Hoxha në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Vietnamit, të Asamblesë Kombëtare, të Këshillit të Shtetit dhe të Këshillit të Ministrave të RS të Vietnamit, Truong Chin, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PK të Vietnamit dhe kryetar i Këshillit të Ministrave, Ngujen Duk Tam, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PK të Vietnamit, Ngujen Ko Tha, kandidat i Byrosë Politike të KQ të PK të Vietnamit dhe ministër i Punëve të Jashtme, Ngujen Suan Jem, nënkryetar i Këshillit të Shtetit, Tran Kuin, nënkryetar i Këshillit të Ministrave, Vu Kuang, anëtar i Komitetit Qendror dhe drejtor i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PK të Vietnamit, gjeneral koloneli Le Tuong Tan, shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe zëvendësministër i Mbrojtjes Popullore dhe shokë të tjerë.

Gjithashtu në ambasadën tonë u vendos kurora e dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Vietnamit, Le Zuan, me mbishkrimin «Me respekt dhe keqardhje shokut Enver Hoxha». Kurora me lule u vendosën edhe në emër të Komitetit Qendror të PK të Vietnamit, të Asamblesë Kombëtare, Këshillit të Shtetit dhe Këshillit të Ministrave të RS të Vietnamit si dhe nga institucione të tjera qëndrore, organizatat e masave, etj.

Kryeministri i Republikës Turke, Turgut Ozal, shkoi në ambasadën tonë në Ankara dhe, në emër të popullit turk si dhe në emrin e tij, shprehu hidhërimin dhe ngushëllime të tyre të thella. Ai shoqërohej nga ministri i shtetit Mesud Jilmaz.

Shkuan gjithashtu në ambasadë për të bërë homazhe Sekretari i Përgjithshëm i Presidentit të Republikës, Sedat Gyneral, ministri i Punëve të Jashtme, Vahit Halefoglu, ish zëvendëskryeministri Hikmet Cetin si dhe shumë miq e dashamirës të tjerë të vendit tonë. Ata me fjalët më të ngrohta, të shkruara në Libër, shprehën ngushëllime të tyre të sinqerta për këtë humbje të madhe të Partisë dhe të popullit tonë. Hikmet Cetin, ndër të tjerë theksoi: «Enver Hoxha e shndërroi Shqipërinë në një vend të pavarur e të nderuar. Ai e mësoi kombin shqiptar dhe gjithë botën se si të jetohej me forcat e veta dhe i pavarur, pa i pasur nevojën askujt. Vdekja e tij është një humbje aq e madhe për vendin dhe popullin e tij sa edhe për tërë botën... Besojmë se Shqipëria gjatë gjithë historisë së saj do të vazhdojë politikën e nderuar dhe shëmbulldhënëse të Enver Hoxhës».

Në ambasadën tonë në Dar Es Salam, shkoi Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Revolucionare të Tanzanisë, Rashidi Kavaja, i cili shprehu ngushëllime dhe firmosi librin në emër të Kryetarit të Partisë dhe Presidentit të Tanzanisë, Xhulus Nierere, të Komitetit Ekzekutiv Kombëtar dhe të gjithë popullit tanzanian. Ishte gjithashtu për ngushëllime edhe ministri i Punëve të Jashtme të Tanzanisë, Mkapa dhe të tjerë.

Në Bukuresht, në ambasadën tonë u vendos një kurorë në emër të presidentit të Republikës Socialiste të Rumanisë, Nikolae Çausheku. Në ambasadë shkuan për të shprehur ngushëllime dhe nënshkruar Librin Emil Bobu, anëtar i Komitetit Politik Ekzekutiv dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Rumanisë, deputet; Jon Stojan, kandidat i Komitetit Politik Ekzekutiv; Jon Totu, zëvendëskryeministër i Republikës Socialiste të Rumanisë, Ilia Veduva, kryetar i Komisionit të Politikës së Jashtme të Asamblesë së Madhe Kombëtare, Kostantin Oancea, zëvendësmnistër i Punëve të Jashtme dhe personalitete të tjera.

Në Konsullatën tonë në Stamboll shprehën ngushëllime një numër i madh personalitete. Valiu i Stambollit Nevzat Ajaz, la në Librin e Ngushëllimeve këtë shënim: «Vdekja e Sekretarit të Parë të Partisë së Punës të Shqipërisë, udhëheqësit Enver Hoxha, ka shkakuar një dhimbje të madhe. Gjatë vizitës në Shqipëri, unë kam parë

KOLEGJUMI I REDAKSISË